



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01 Nr. 112-6508 /2016

Dt. 03.02.2016

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo – Arsimor dhe Aftësues dhe kërkesës së Drejtorisë së Arsimit nr.zytr.04/1575 e dt. 27.01.2016, me datë 03.02.2016, merrë:

V E N D I M

1. Z. Albert Zajmi, nga Gjakova, i sistemuar në punët dhe detyrat e punëve Drejtor në Shkollën Fillore “ EMIN DURAKU “ në Gjakovë i vazhdohet kontrata e punës Drejtor pranë të njëjtës shkollë edhe për një mandat, për periudhën kohore katër (4) vjeçare.
2. Të ardhurat personale për këtë vend pune ti llogariten sipas vlerës së koeficientit 7.8.

A r s y e t i m

Z. Albert Zajmi, i sistemuar në punët dhe detyrat e punëve Drejtor pranë Shkollës Fillore “ EMIN DURAKU ” në Gjakovë, pas vlerësimit të performancës së bërë nga Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim znj. Diana Qarkaxhija dhe rezultateve të punës të mira në aktivitetin profesional dhe në aktivitete tjera në fushën e edukimit dhe të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, u rekomandua që ti vazhdohet kontrata e punës Drejtor pranë të njëjtës shkollë edhe për një mandat për periudhën kohore katër (4) vjeçare.

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Arsim si dhe dispozitave ligjore të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Edukativo – Arsimor dhe Aftësues, z. Albert Zajmi, i vazhdohet kontrata e punës Drejtor në Shkollën Fillore “ EMIN DURAKU “ në Gjakovë K. Gjakovë, në periudhën kohore katër (4) vjeçare dhe atë nga data 02.03.2016 e deri me 02.03.2020.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë aktvendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

Vendimi iu dorëzohet: Kryetares së Komunës, z. Albert Zajmi, Drejtorisë për Arsim, Udhëheqësit të Personelit, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit.

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari - Lila

